

VENDIM
Nr.806, datë 6.10.2010

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS PETRAN, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Petran, të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Petran të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.104, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Petran, të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Petran për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Petran
nr. 1

Lidhja

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
3-20	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
21-27	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore.	Në pronësi
31-45	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
46-58	Varrezat publike	Në pronësi
63-79	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
80,81,83-86,88-89,91-94, 96-98,100-102,104-105,107-110,112- 114,116-118,120-122,124-125,127- 130,132,134-137,139-142	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
82,87,90,95,99,103,106,111,115, 119,123,126,131,133,138,143,151, 152,165,168,176,177,184,185,195, 196 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
1020-1028	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve	Në pronësi

	në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	
1031-1033	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
1034-1055	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi